



# Analizë: Fushata e Zgjedhjeve Lokale

20 Tetor 2017, Prishtinë

---

## Përmbajtja

<b>1. INFORMATË E PËRGJITHSHME</b> .....	2
<b>1.1. Procesi i Zgjedhjeve Lokale</b> .....	2
<b>1.2. Kandidatët që garojnë për Zgjedhje Lokale</b> .....	2
<b>1.3. Menaxhimi i Zgjedhjeve</b> .....	2
<b>1.4. Vëzhgimi në Ditën e Zgjedhjeve</b> .....	3
<b>2. ANALIZA E PËRGJITHSHME</b> .....	3
<b>2.1. Pasqyrim i Procesit Zgjedhor</b> .....	3
<b>2.2. Analizë mbi Premtimet e Kandidatëve për Kryetarë të Komunave</b> .....	4
<b>2.3. Gjuha përgjatë Zgjedhjeve</b> .....	5
<b>2.4. Debatet dhe Përfaqësimi përgjatë Zgjedhjeve</b> .....	5
<b>3. TË DALAT &amp; KONKLuzionET</b> .....	6
<b>4. REKOMANDIMET</b> .....	7

# 1. INFORMATË E PËRGJITHSHME

## 1.1. Procesi i Zgjedhjeve Lokale

Më 22 Tetor të vitit 2017, Republika e Kosovës mban zgjedhjet lokale. Rreth 1.9 milion votues të regjistruar do të kenë mundësinë të bëjnë përzgjedhjen për Kryetarë të Komunave dhe Këshilltarë Komunalë në 38 komuna. Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), 91 entitete politike janë certifikuar për garën e zgjedhjeve lokale 2017, duke përfshirë: 35 parti politike, 30 iniciativa qytetare, 1 koalicion dhe 25 kandidatë të pavarur<sup>1</sup>. Fushata zgjedhore ka filluar më 21 Shtator 2017 dhe do të përfundojë më 20 Tetor 2017. Ndërkaq, balotazhet zgjedhore janë caktuar të mbahen më 19 Nëntor 2017. Për votimin ndaj këshilltarëve komunalë, procesi i votimit bëhet përmes një sistemi me listë të hapur dhe proporcionale, ku votuesit përzgjedhin partinë politike të preferuar dhe kandidatin e preferuar në listat për Kuvendet Komunale. Ulëset në Kuvendet Komunale alokohen bazuar në formulën e përqindjes së votave që një parti e caktuar merr. Ndërkaq, gara për Kryetarë të Komunave është e bazuar në sistemin mazhoritar. Komisioni i Zgjedhjeve do të hapë 2,505 vendvotime në 899 qendra të votimit në Kosovë<sup>2</sup>, duke përfshirë komunat e veriut me shumicë Serbe.

## 1.2. Kandidatët që garojnë për Zgjedhje Lokale

Janë 204 kandidatë që do të garojnë për Kryetarë të Komunave dhe 7,080 kandidatë që do të garojnë për 901 vende në 38 komuna për Kuvende Komunale. Për fat të keq, vetëm 8 nga 204 kandidatë për Kryetarë të Komunave janë gra.

## 1.3. Menaxhimi i Zgjedhjeve

Bazuar në Ligjin për Zgjedhje Lokale, secila komunë konsiderohet si njësi e veçantë zgjedhore, ku Kryetarët e Komunave përzgjidhen nëpërmes një fletëvotimi të ndarë. Përderisa, Këshilltarët Komunalë përzgjidhen në një listë të hapur të partive politike, me 30 për qind të kuotës gjinore.

*Në vendvotim, votuesit do të marrin dy fletëvotime të ndryshme:*

*Tabela 1.3.1*

<i>Fletëvotimi</i>	<i>Përshkrimi</i>
<i>Kuvendi Komunal</i>	Për Kuvendin Komunal, votuesit mund të përzgjedhin një entitet politik, e po ashtu një votë për një kandidat që vjen nga lista e partisë politike. Në rastet kur një votues përzgjedh në listë më shumë se një kandidat, vota shkon vetëm për bartësin e listës të partisë politike.
<i>Kryetari i Komunës</i>	Votuesit duhet të votojnë vetëm për një kandidat për Kryetar të Komunës. Nëse kandidati merr 50 për qind plus një votë nga totali i votave, kandidati zgjidhet si Kryetar Komune. Megjithatë, nëse të gjithë kandidatët marrin më pak se 50 për qind plus një nga totali i votave, atëherë shkohet në balotazh.

<sup>1</sup> <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/343>

<sup>2</sup> [http://kqz-ks.org/Uploads/Documents/1762-2017%20Vendim%20per%20certifikimin%20e%20listes%20perfundimetarete%20votuesve\\_2017-09-22\\_1\\_eaylgbihig.PDF](http://kqz-ks.org/Uploads/Documents/1762-2017%20Vendim%20per%20certifikimin%20e%20listes%20perfundimetarete%20votuesve_2017-09-22_1_eaylgbihig.PDF)

## 1.4. Vëzhgimi në Ditën e Zgjedhjeve

Afati për aplikim për akreditimin e personave për vëzhgim në zgjedhje në emër të organizatave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka qenë deri më 9 Tetor 2017. Gjithsej 32,509 vëzhgues janë akredituar për zgjedhje lokale<sup>3</sup>, të kategorizuar si në vijim:

Tabela 1.4.1

Vëzhguesit	Numri i Vëzhguesve	Përshkrimi për angazhimin
<b>Entitete Politike</b>	28,059	Entitetet politike do të vëzhgojnë procesin e zgjedhjeve në emër të partive politike që u takojnë. Zakonisht përfaqësuesit e tyre qëndrojnë në qendra të votimit deri në përfundim të procesit.
<b>Institucionet Ndërkombëtare (Përfaqësues të Jashtëm të Komisioneve Zgjedhore)</b>	12	Institucionet ndërkombëtare vëzhgojnë rrjedhën e përgjithshme të procesit.
<b>Ambasadat</b>	37	Përfaqësuesit nga Ambasadat vëzhgojnë procesin e votimit në komuna dhe përçojnë mesazhe për një proces të drejtë dhe demokratik.
<b>Organizatave Ndërkombëtare (përfshirë EU EOM)</b>	151	Organizatave ndërkombëtare janë vëzhgues të specializuar që kanë eksperiencë dhe janë të pavarur në procesin e monitorimit, e po ashtu zhvillojnë raporte për procesin.
<b>Organizatave Lokale</b>	3,782	Përfaqësuesit e Organizatave Lokale vëzhgojnë dhe zhvillojnë raporte periodike për procesin e zgjedhjeve. Përfaqësuesit paraqesin rrjedhën dhe problemet që mund të dalin nga ky proces.
<b>Media (Lokale dhe ndërkombëtare)</b>	468	Mediat Lokale dhe Ndërkombëtare vëzhgojnë procesin dhe informojnë publikun përmes lidhjeve direkte dhe kronikave.

## 2. ANALIZA E PËRGJITHSHME

### 2.1. Pasqyrim i Procesit Zgjedhor

Instituti KLGJ vlerëson se kampanja elektorale zhvillohet në linjë me standardet ndërkombëtare<sup>4</sup> për zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike. Zgjedhjet lokale janë të një rëndësie të veçantë, marrë parasysh se qytetarët zgjedhin drejtpërdrejt Kryetarët e Komunave dhe Këshilltarët Komunalë. Sistemi me listë të hapur dhe proporcional nxit pjesëmarrjen, u mundëson votuesve të zgjedhin drejtpërdrejt përfaqësuesit e tyre dhe avancojnë demokracinë e

<sup>3</sup> [http://www.ifes.org/sites/default/files/2017\\_ifes\\_kosovo\\_local\\_election\\_faqs\\_final.pdf](http://www.ifes.org/sites/default/files/2017_ifes_kosovo_local_election_faqs_final.pdf)

<sup>4</sup> <http://www.osce.org/odihr/16935?download=true>

brendshme politike. Për një muaj, partitë politike dhe kandidatët kanë shfrytëzuar mundësitë për të prezantuar programet dhe vizionet ndaj qytetarëve.

Zgjedhjet lokale 2017 shënojnë herën e dytë të zgjedhjeve me pjesëmarrjen e komunave të veriut me shumicë Serbe. Kampanja në komunat e veriut ishte paqësore dhe pa incidente.

Kjo kampanjë elektorale njihet për dinamikën e diskursit publik dhe një seri debatesh intensive të kandidatëve. Partitë politike dhe kandidatët kyç janë angazhuar në kampanja strategjike derë më derë me qytetarët, e po ashtu takime publike me mbështetës të partive. Krahasuar me zgjedhjet lokale në 2013, këto zgjedhje njihen më shumë për parti politike dhe kandidatë me strategji dhe taktika elektorale. Rrjetet sociale, takimet me qytetarë dhe vizitat derë më derë shënojnë përmirësime krahasuar me zgjedhjet e kaluara ku në atë kohë partitë dhe kryetarët janë përballur me mungesë të diskutimeve të fokusuara mbi prioritetet dhe politikat e komunave.

Krahasuar me zgjedhjet e kaluara, partitë politike kanë respektuar më shumë Kodin Etik të Mirësjelljes. Megjithatë, shumë parti janë penalizuar për përdorimin e fëmijëve në materialet e promovimit dhe ngjarjet për kampanja.

*Rezultatet reflektojnë këtë situatë:*

*Tabela 2.1.1.*

<i>Niveli Zgjedhor i Qeverisjes/Viti</i>	<i>Gjobat</i>
<i>Zgjedhjet Lokale 2013</i>	190,550 €
<i>Zgjedhje Qendrore 2017</i>	352,000 €
<b>ZGJEDHJET LOKALE 2017</b>	<b>Rreth 153,000 €<sup>5</sup></b>

## **2.2. Analizë mbi Premtimet e Kandidatëve për Kryetarë të Komunave**

Kandidatët për Kryetarë të Komunave kanë prezantuar programe më reale dhe më në linjë me kapacitetet financiare dhe lokale krahasuar me zgjedhjet e kaluara lokale. Megjithatë, Instituti KLLGI vlerëson se prezantimet në debate nuk kanë prodhuar mundësi dhe nuk kanë shpërfaqur një pamje të qartë transformuese.

Janë pesë çështje që dalin si prioritete në Kosovë:

- Niveli i lartë i papunësisë;
- Edukimi jo-kualitativ dhe shërbimet shëndetësore të fragmentuara;
- Mungesa e ujit të pijshëm, mbrojtja e ambientit, pastërtia dhe mbledhja e mbeturinave;
- Pakënaqësia e madhe e qytetarëve me performancën e autoriteteve në ofrimin e shërbimeve publike dhe administrative;
- Mungesa e hapësirave për rini, kulturë dhe sport.

Shkalla e lartë papunësisë është pasqyrim direkt i mungesës së zhvillimit substancial ekonomik, programeve kuptimplotë për mirëqenie, kujdesit efektiv social dhe programeve për punësim. Megjithatë, kandidatët për Kuvende Komunale vazhdojnë të kenë mungesë të informimit të

<sup>5</sup> Kjo vlerë mund të ndryshojë deri më 22 Tetor

duhur për kompetencat dhe autoritetin e komunave. Kandidatët për Kryetarë të Komunave po ashtu kanë mungesë të informatave për përgjegjësitë e Kryetarëve.

Në tabelën më poshtë janë të paraqitura disa shembuj për premtimet e kandidatëve që nuk janë përputhje me kornizën aktuale ligjore:

*Tabela 2.2.1*

<b>Premtimet që nuk kanë përputhshmëri me kompetencat/premtimet e komunave dhe që nuk mund të përmbushen nga vetë komunat</b>	<b>Premtimet që tejkalojnë mundësitë financiare dhe rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare</b>
Zhvillimi i programeve në fushën e arsimit (kompetencë e Ministrisë së Arsimit)	Shpenzimet shtesë për stafin që rrisin numrin e kontratave mbi shërbime dhe pagesat për praktikë për periudhë një-vjeçare
Furnizimi me ujë dhe zgjerimi i rrjetit (kompetencë e përbashkët me ndërmarrjet dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik)	Marrja e përgjegjësisë për pagesat e lehonisë
Themelimi i ndërmarrjeve të reja publike në komuna (kompetencë e komunave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik)	Marrja e përgjegjësisë për pagesat e shujtave për studentët në shkolla
Ndërtimi i zonave ekonomike dhe të bizneseve (Kompetencë e komunave, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Bujqësisë)	Marrja e përgjegjësisë për shpenzimet e varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave
Taksat e Biznesit që nuk janë të parapara me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal	Ulja e taksave të pronës
Prezantimi i investimeve kapitale pa marrë në konsideratë buxhetin dhe fondet	Rritja enorme e kategorive të subvencioneve

### **2.3. Gjuha përgjatë Zgjedhjeve**

Përgjithësisht, gjuha e kandidatëve ka qenë e kujdesshme. Kjo ka rezultuar në reduktimin e tensioneve dhe incidenteve që mund të dëmtojnë procesin e përgjithshëm zgjedhor. Shtatëmbëdhjetë (17) incidente janë raportuar në Policinë e Kosovës, ku janë ngritur katër (4) vepra penale<sup>6</sup>. Edhe pse gjuha ka qenë e kujdesshme, ka pasur akuza dhe padi për shpifje në mes të kandidatëve.

### **2.4. Debatet dhe Përfaqësimi përgjatë Zgjedhjeve**

Televizioni dhe mediat elektronike kanë pasur një prezantim të qartë dhe pothuajse korrekt. Çdo kandidat ka pasur mundësinë e prezantimit të programeve dhe konfrontimit me kandidatët e tjerë. Këto debate janë transmetuar nga programe nacionale, si:

- **KLAN Kosova:** “Magazina Lokale”, “Analiza Lokale” dhe “Info Lokale”;
- **Kohavizion:** “Koha Lokale” and “Interaktiv”;
- **RTK:** “Zgjedhjet Lokale”;

<sup>6</sup> <http://www.koha.net/zgjedhjet-lokale-2017/51840/kqz-per-diten-e-zgjedhjeve-jane-angazhuar-86-prokurore/>

- **RTV 21:** “Debat Përnime/Jeta në Kosovë”;
- **RTV Dukagjini:** “Debat Plus (Plus Debate)” dhe “Debat D”;
- **Tribuna Channel:** “Fakt Plus” dhe “Tribuna Zgjedhore”:
  - **Programet televizive të komunave me shumicë Serbe RTK 2**
  - **TV Most**
  - **TV Graçanica**
  - **RTV Puls**

### 3. TË DALAT & KONKLuzionET

- Edukimi i duhur për procesin e votimit mbetet shqetësim. Në zgjedhjet qendrore ka pasur mbi 50,000 vota<sup>7</sup> të pavlefshme;
- Ka mungesë të praktikave, modeleve, njohurive dhe hapësirave për prezantimin e kandidatëve për Kuvende Komunalë, marrë parasysh numrin e madh të tyre;
- Shumë kandidatë kanë premtuar përmirësim në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit. Megjithatë, politizimi i këtyre sektorëve të rëndësishëm mbetet ende shqetësim. Rreziku këtu qëndron te kandidatët fitues të cilët shpërblejnë votuesit dhe mbështetësit e tyre besnik përmes zëvendësimit të stafit dhe administratës;
- Kandidatët për Kuvende Komunale nuk kanë prezantuar strategji të qartë lidhur me mënyrën se si do të përmbushin premtimet elektorale (p.sh. Si do të avancojnë barazinë gjinore kandidatet gra? Si do të adresojë rinia promovimin e interesit të të rinjve? Si do të avancojnë kandidatët biznesmenë politikat ekonomike? Si do të mbrojnë sindikalistët të drejtat e punëtorëve?);
- Kampanja elektorale për tridhjetë (30) ditë është e gjatë dhe ka rezultuar në apati dhe lodhje të votuesve. Shumica e kandidatëve kanë filluar kampanjën para fushatës zyrtare;
- Kandidatët për Kryetarë të Komunave nuk janë plotësisht të lidhur me komunën për të cilën garojnë dhe nuk jetojnë në komunën për të cilën garojnë. Për më tepër, kandidatët për Kryetarë Komunash vijnë nga niveli qendror, trembëdhjetë (13) nga ta vijnë nga Parlamenti i Kosovës;
- Bartësi i listës së partisë politike është i privilegjuar dhe nuk konkurren barabartë me kandidatët e tjerë. Në shumicën e rasteve, bartësi i listës së partisë politike favorizon kandidatët nga e njëjta listë.

<sup>7</sup> <http://rezultatet.kqz-ks.org/Results.aspx?RaceID=1&UnitID=1&IsPS=0&Turnout=0&LangID=2>

## 4. REKOMANDIMET

*Instituti KLLGI rekomandon:*

- që të ketë kampanjë kuptim-plotë dhe strategjike për nxitjen e grave në gara për zyrat publike;
- që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të angazhohet në kampanjë efektive për edukimin e votuesve dhe ti informojë ata lidhur me rëndësinë e votës dhe procedurat e sakta të votimit;
- që kohëzgjatja e kampanjës të zvogëlohet në tri javë në mënyrë që të shmanget lodhja;
- që partitë politike të fuqizojnë rininë në garat për zgjedhje dhe të promovojnë modele të lidërshipt transformues;
- që të rregullohet me kornizë ligjore nëse kandidatët që mbajnë pozita në nivelin qendror mund të hyjnë në garë për nivelin lokal apo jo;
- që korniza ligjore të parandalojë partitë politike fituese të bëjnë zëvendësime për shërbyesit civilë bazuar në baza partiake. Aktualisht, zgjedhjet lokale po fusin në presion dhe po krijojnë shqetësim tek arsimtarët dhe profesionistët në shëndetësi;
- Partitë politike dhe kandidatët duhet të tregojnë vendosmëri dhe të bëjnë thirrje të fuqishme për një proces të lirë, demokratik dhe paqësor.





Kosovo Local Government Institute  
Adresa: Rr. Enver Gjerqeku no. 20, 10000  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 (0) 38 522 000  
Mob: +377 (0) 44 253 835  
E-mail: [info@klgi-ks.com](mailto:info@klgi-ks.com) | Web: [www.klgi-ks.com](http://www.klgi-ks.com)